

K Ë R K E S Ë

Kërkues: Luigj Toma, i biri i Nikës, lindur në Krujë dhe banues në lagjen "16 prilli", të ish-hotel "Vjosa" Fier.

Objekti: Shpallja të zhdukur të bashkëshortes sime Magdalena Sami Toma, në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë. Që në vitin 1991 jam martuar me Magdalena Toma dhe me të kam lindur dy fëmijë. Bashkëshortja ime më 27 janar të vitit 1997 së bashku me dy kushërinjtë e mi të quajtur Ludovik Toma dhe Agustin Keçani me një skaf janë nisur nga Vlora për në drejtim të Italisë. Po atë ditë skafi ku gjendej edhe bashkëshortja ime rreth 1500 m larg bregut ka pësuar defekt. Klandestinët e ndodhur në të, disa u mbytën dhe disa të tjerë shpëtuan. Në këtë ngjarje u mbyt edhe bashkëshortja ime Magdalena Toma. Që është mbytur e tregon fakti që ajo as doli në breg e shpëtuar as edhe nuk u gjet e mbytur. Fakti që prej asaj kohe kanë kaluar plot dy vjet tregon se ajo është e mbytur. Që nga ajo kohë deri më sot nuk kemi asnjë lloj sinjali që të vërtetojë që ajo të jetë e gjallë.

KËRKUESI
Luigj Toma